

SCIENTIFIC AND CULTURAL MAGAZINE

Univers

REVISTË SHKENCORE KULTURORE



Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam
Albanian Institute of Islamic Thought & Civilization

2020 Nr. 21
ISSN 2414-8784



Drejtor:

Dr. Ardian Muhaj

Kryeredaktor:

Prof. As. Dr. Ramiz Zekaj

Redaksia:

Prof. Dr. Arian Kadiu
Prof. Dr. Hamit Boriçi
Prof. Dr. Muharrem Dezhgiu
Prof. Dr. Ramazan H. Bogdani
Prof. Dr. Nevila Nika
Prof. Dr. Seit Mansaku

Bordi këshillimor:

Abdulatif ARNAUTI – (shkrimtar, Damask)
Dr. Yahja bin JUNAIID – (studiues, Arabia Saudite)
Dr. Ali ILJAZI – (mjek, Gjakovë)
Prof. Dr. Basil SCHADER – (gjuhëtar, Zyrih)
Dr. Enes KARIÇ – (studiues, Sarajevë)
Prof. Gudar BEQIRAJ – (akademik, Tiranë)
Prof. Dr. Gjovalin SHKURTAJ – (gjuhëtar, Tiranë)
Dr. Ismail BARDHI – (teolog, Shkup)
Prof. Ismail BUÇAKÇI – (historian, Athinë)
Prof. Machiel KIEL – (historian, Amsterdam)
Dr. Maksut HAXHIBRAHIMI – (studiues, Ulqin)
Prof. Dr. Njazi KAZAZI – (gjuhëtar, Shk odër)
Prof. Dr. Mehmet ÇELIKU – (gjuhëtar, Elbasan)
Prof. Dr. Mevlud DUDIÇ – (studiues, Novi Pazar)
Prof. Dr. Muhamed ARNAUTI – (historian, Aman)
Prof. Dr. Vebi BEXHETI – (pedagog, Tetovë)
Prof. As. Dr. Rexhep BOJA – (teolog, Prishtinë)
Dr. Saif Bin Rashid AL GABIRI - (studiues, Dubai)
Dr. Tahir KUKAJ – (studiues, Staten Island, New York)

Revista “Univers” botohet dy herë në vit. Artikujt e paraqitur duhet të përmbajnë punime origjinale dhe të pabotuara më parë. Ata duhet të jenë të kompjuterizuar, të jenë nga 8-12 faqe format A4, në gjuhën shqipe, me shkrim Times New Roman të madhësisë 12 dhe me hapësirë 1.5 ndërmjet rreshtave. Materialet shoqërohen me një përmbledhje në gjuhën shqipe dhe/ose angleze dhe me referencat përkatëse, të cilat duhet të përmbajnë emrin e autorit, titullin e plotë të burimit (të librit ose artikullit), vendin dhe vitin e botimit, si dhe faqen referuese. E drejta e autorësisë për artikujt e botuar i takon Institutit Shqiptar të Mendimit dhe të Qytetërimit Islam, por autori është i lirë t’i përdorë materialet e tij edhe në botime të tjera, me kusht që referimet t’i bëhen revistës “Univers”, si vendi i parë i botimit.



Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam
Albanian Institute of Islamic Thought & Civilisation

Koordinatorë: Anisa Hykaj

Redaktore letrare: Anila Ferizaj

Korrektore gjuhësore: Oriola Sula

Përpunimi grafik: Ilmi Shahu

© Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam

📍 Rr. Isuf Elezi Nr.10, Vilat Selitë, P.O.Box. 2905 – Tiranë

☎ 0035542215087, 0035542215089 📄 0035542215086

✉ revistaunivers@aiitc.net, contact@aiitc.net 🌐 www.aiitc.net



Shtypur në shtypshkronjën: “MILENIUMI I RI”

📍 Autostradë Tiranë - Durrës, km 26

☎ 00355 672063702

✉ info@mileniumiri.al 🌐 www.mileniumiri.al

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Univers

EDITORIAL

Nevoja e kapërcimit të inercisë metodologjike në studimet shqiptare	13
--	----

STUDIME

<i>Prof. Dr. Arian Kadiu</i> Shqetësime e përballje të shkollës dhe prindërve me adoleshentin e sotëm	19
<i>Dr. Kujtim Nuro</i> Burimet historike nën këndvështrimin e rilindasve dhe intelektualëve shqiptarë	20
<i>Abdulsalam Alkholidi, Habib Hamam</i> Potencialet e energjisë diellore në vendet e Europës juglindore	21
<i>Dr. Alban Dobruna</i> Kontributi i tarikateve islame në komitetin "Mbrojtja kombëtare e Kosovës"	22
<i>Dr. sc. Sejdi M. Gashi</i> Sistemi emëror i të folmes së Istogut me rrethinë.....	23
<i>Artan S. Mehmeti</i> Kontributi i El-Mesudit dhe El-Idrizit në shkencën e gjeografisë dhe historisë	24

HORIZONTE SHOQËRORE

<i>Prof. Dr. Ramazan H. Bogdani</i> Tek arbëreshët e Italisë.....	27
<i>Dr. Dorina Arapi</i> Shkodra, një dëshmi e konvergimit kulturor në panoramën e mes shekullit XIX.....	28
<i>Dr. Armanda Hysa</i> Metodologjia e mbledhjes së materialeve mbi jetën tradicionale në etnografinë shqiptare gjatë diktaturës.....	29

<i>Ramazan Fetahu PhD(c)</i> Sfondi estetik në poemën “Dashuria” (eros) të Naim Frashërit	30
--	----

ART, KULTURË DHE TRADITË

<i>Prof. Dr. Rexhep Meidani</i> Hasan Tahsini, dijetari e patrioti që meriton një vend të veçantë në panteonin kombëtar të dijes	33
<i>PhD Matilda Likaj Shaqiri</i> Analizë sociologjike e fesë, edukimit dhe familjes: Shembulli i rolit të gruas në Islam	34
<i>Jonada Dervishi</i> Prania e mitit në veprën “Kështjella” të Kadaresë	35

OPINIONE

<i>Dr. Husein Rizai</i> Hutbeja si bartëse e mesazhit hyjnor në botën moderne	39
<i>Prof. Dr. Kopi Kÿçyku</i> E drejta islame	40
<i>Anisa Hykaj</i> Komunikimi muzeor si dëshmi e lashtësisë dhe e identitetit kombëtar	41
<i>Smajl Bala</i> Historia e institucioneve arsimore islame të zonës së Shkodrës: Mejtepet	42
<i>Xhyllferie Bahtijari</i> Kriza financiare globale dhe ndikimi i saj në bankat konvencionale dhe ato islame	43
<i>Dr. Saimir Shatku, Armand Skrapi PhD(c)</i> Konventat ndërkombëtare mbi përfaqësimin diplomatik dhe rastet praktike të funksionimit të tyre	44

DOKUMENTE

Nuridin Ahmeti

Marrëdhëniet midis Kosovës dhe Shqipërisë në vitin 1974.
Sipas një raport-programi sekret të Mr. Ukshin Hoti..... 47

BOTIME NË FOKUS

Prof. Dr. Mustafa Ibrahim

Vepra “Areali gjuhësor i Istogut me rrethinë”
e autorit Dr. Sejdi Gashi, vlerë e re për gjuhësinë shqiptare 51

Oriola Sula

Monografia “Banesat shqiptare me qoshk” e Prof. Dr. Emin Riza –
Dëshmi e zhvillimit të arkitekturës shqiptare..... 52

EDITORIAL

Univers

NEVOJA E KAPËRCIMIT TË INERCISË METODOLOGJIKE NË STUDIMET SHQIPTARE

Zhvillimi i disiplinave shkencore të studimeve shqiptare, ose ato që është bërë zakon të quhen albanologjike, ku spikat historiografia dhe gjuhësia në dy dekadat e para të shekullit XXI, duhen kuptuar në kuadrin e përgjithshëm të shoqërisë në tërësi. Kjo shoqëri përballet me problemet e një tranzicioni të zgjatur, që në fakt, mund të shihet më qartë, nëse e konceptojmë më shumë si një inerci nga një periudhë e mëhershme, sesa si lëvizje e mirorientuar drejt një caku të përcaktuar qartë.

Në këtë aspekt, studimet shqiptare, ashtu si edhe tërësia e shoqërisë, ndodhen në një farë mase të ngujuara akoma në shekullin XX, apo në atë që do të mund të konsiderohet si shekulli i gjatë i njëzetë shqiptar. Metodatat dhe qasjet nuk kanë ndryshuar, në përputhje me zhvillimet ballkanike dhe europiane. Tkurrja e burimeve ekonomike dhe njerëzore në komunitetin e studiuesve ka sjellë një konservatorizëm të dukshëm në tërësinë metodologjike, që njëkohësisht i përshtatet prirjes së përgjithshme të inercisë shoqërore, por edhe kontribuon në këtë zgjatje të shekullit të njëzetë historik edhe në shekullin e njëzetë e një kronologjik.

Paradigma dhe diskursi mbizotërues, po ashtu, ndjekin ritmin e kësaj inercie. Shkaqet e një inercie apo zgjatjeje të periudhës historike dhe historiografike, përtej periudhës kronologjike, janë të shumta dhe mund të grupohen si shkaqe të përgjithshme, pra që janë gjithëshoqërore dhe të përveçme, pra shkaqe të lidhura me vetë disiplinën shkencore përkatëse. Pasojat gjithashtu janë gjithëshoqërore dhe disiplinore. Reformimi metodologjik i këtyre disiplinave shkencore, natyrisht, nuk mund të pritet që të ketë një dinamikë dukshëm më të përshpejtuar sesa transformimi i përgjithshëm i shoqërisë. Megjithatë, studiuesit e këtyre disiplinave shkencore janë një nga komunitetet, respektivisht fushat, që lipeset të jenë në ballë të reformimit dhe të transformimit të përgjithshëm shoqëror, drejt një caku të projektuar në të ardhmen dhe të daljes nga peshë e inercisë së shekullit XX.

Në të tilla periudha, kur e kaluara peshon aq rëndë në të tashmen dhe në

të ardhmen, reformimi metodologjik, përmes zgjerimit dhe rikonceptimit të qasjeve dhe metodave të hulumtimit, duhet të shihet i lidhur ngushtë me ndërjegjësimin mbi efektin që ka ripërshtatja e subjektit hulumtues (studiuesit) ndaj vetë fushës së studimit. Reformimi metodologjik duhet të paraprihet ose të shkojë paralelisht me përshtatjen e studiuesit ndaj zhvillimeve të shoqërisë dhe të shkencës në tërësi.

Një shembull i dukshëm i kësaj është rasti i studimeve historike, ku vërehet se qasjet dhe metodat e reja metodologjike që qëndrojnë në bazat e nënfushave aq të rëndësishme, siç janë prosopografia, historia ekonomike apo historia detare, mungojnë tërësisht në fokusin kërkimor të historianëve. Po ashtu, metodat sasiore në përgjithësi lihen mënjanë dhe nuk përdoren. Nëse do e përdornim metodën sasiore për të bërë një matje të vetë prodhimit historiografik, do të haseshim me një shpërndarje asimetrike lehtësisht të dukshme në kërkimin historik, në aspektin kronologjik dhe tematik. Edhe shkencat e tjera të studimeve shqiptare, si gjuhësia, etnologjia apo antologjia kulturore, pavarësisht përpjekjeve të studiuesve, përballen me sfida e vështirësi të shumta.

Është e kuptueshme se në këtë ka ndikuar edhe turrja e burimeve njerëzore në komunitetin e studiuesve të këtyre fushave. Kjo turrje, e ndërthurur edhe me zvogëlimin e mbështetjes ekonomike, ka sjellë si pasojë këtë konservatorizëm dhe ngurtësim metodologjik. Kjo inerci dhe ky ngurtësim metodologjik pasqyrohet, nga ana e vet, në një prirje për izolim të dukshëm të këtyre studiuesve, për sa i përket lidhjeve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Studiuesit shqiptarë në përgjithësi, marrin pjesë shumë pak në konferenca e takime shkencore ndërkombëtare. Në këtë aspekt, duhet thënë se mbështetja e pamjaftueshme është shkaku kryesor. Megjithatë, epoka digjitale dhe interneti i kanë ulur kostot e shumë prej proceseve të kërkimit shkencor dhe, për këtë arsye, mund dhe duhet të shihet si një mënyrë për të kompensuar mbështetjen e pamjaftueshme nga autoritetet përgjegjëse. Mirëpo, edhe në shfrytëzimin e këtij mjeti të përbotshëm, i cili ngadalë po e transformon shkencën dhe mënyrën e kërkimit shkencor, ka mungesë ndërjegjësimi institucional dhe social.

Është për t'u theksuar, se studimet albanologjike, veçanërisht ato të historisë, kanë reflektuar në përputhje me disa direktiva të organizmave ndërkombëtare si Këshilli i Europës e të tjerë, që kërkojnë ndërtimin e urave të bashkëjetesës ndërmjet popujve fqinjë dhe, në këtë aspekt, shumë tekste e qasje kanë ndryshuar dhe janë përshtatur. Megjithatë, edhe pse është një hap i rëndësishëm në ndërtimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë në Ballkan e më tej, përshtatja me këto direktiva të organizmave

ndërkombëtare ka hasur në reciprocitet të pamjaftueshëm nga ana e historiografëve fqinjë. Nga ana tjetër, ka shkuar më tej sesa është dashur, duke tentuar që krijimin e këtyre urave ta ndërtojë mbi harresën dhe jo mbi kujtesën historike.

Në anën tjetër, vërehet një kontradiktë mes ngurtësimit metodologjik dhe qëndrimit këmbëngulës në qasje e teza të formësuara në kushtet e mungesës së lirisë së mendimit dhe të diktatit të periudhës komuniste, për aspekte të kulturës e historisë brendashqiptare dhe përshtatjes së tepruar për çështje të marrëdhënieve me fqinjët.

Nevoja e kapërcimit të kësaj gjendjeje inercie e ngurtësimi të brendshëm dhe përkulshmërie e lejueshmërie të jashtme është e madhe dhe e menjëhershme. Kjo për shumë arsye, por më kryesoret janë: së pari, rikthimi i vëmendjes së brezave të rinj ndaj çështjeve të kulturës shqiptare dhe së dyti, përballja e studiuesve me formim të mirëfilltë akademik me valën e populizmit të deformuar në shkencë, veçanërisht në studimet shqiptare. Ndërmjet ngurtësimit metodologjik dhe paradigmës së vjetruar si dhe indiferencës e mosinteresit gjithnjë e më të madh të të rinjve për kulturën dhe dijen e trashëguar, kanë gjetur vend veprimi studiues të vetarsimuar dhe të pasionuar mbi të njëjtat çështje, por me formim akademik jo të plotë.

Studiuesit shqiptarë e kanë vuajtur izolimin dhe mungesën e përditësimit me metodat e arritjet shkencore ndërkombëtare gjatë periudhës së diktaturës komuniste, por edhe periudha e tranzicionit të tejzgjatur nuk ka arritur të ndryshojë shumë në këtë drejtim. Për këtë arsye, nevoja e tejkalimit të inercisë metodologjike në studimet shqiptare bëhet gjithnjë e më e madhe, sa më i madh bëhet përparimi i shkencës në tërësi në vendet fqinje e më gjerë.

STUDIME

Univers

SHQETËSIME E PËRBALLJE TË SHKOLLËS DHE PRINDËRVE ME ADOLESHENTIN E SOTËM

Shoqëria shqiptare, pas viteve '90, u përball me dukuri të panjohura që sollën ndryshime thelbësore në mënyrën e të menduarit dhe të vepruarit. Shndërrimet e thella demokratike në fushat e ndryshme të veprimtarisë njerëzore, si ato politike, ekonomike, sociale, arsimore, kulturore etj., kanë futur në vorbullën e tyre edhe nxënësit e shkollave, sidomos adoleshentët. Specialistët i kanë parë këto probleme të lidhura në tri plane: në aspektin pedagogjik, psikologjik e social.

Ky studim synon të nxjerrë në pah problematikën e përballjes së shkollës dhe prindërve me adoleshentin e sotëm. Ndërtimi i marrëdhënieve normale me të rinjtë e shkollës së mesme, nga mësuesit dhe prindërit, është një proces i vështirë që kërkon më shumë dije dhe mjeshtri pedagogjike. Studiuesit theksojnë se është e gabuar të akuzosh shkollën si shkak i kriminalitetit, papunësisë, i degradimit të vlerave etj. Pra, është e nevojshme të kuptohet se jo gjithçka mund ta bëjë shkolla. Ajo synon të realizojë qëllimet mësimore dhe edukative, megjithatë në shkollat tona ka ende rrëmujë e konflikte. Prandaj roli i familjes si mbështetës dhe plotësues të veprimtarisë edukative shkollore ndihmon për kryerjen e detyrave nga nxënësi.

Kuptohet se sjellja e pahijshme, konfuzioni që shfaq i riu në shkollë vjen shpesh me shkak nga familja, nga grindjet, debatet që hera-herës janë fyese etj. Ndaj lipset që familja të bashkëpunojë me mësuesit për shmangien e këtyre konflikteve.

Një nga funksionet e edukimit është ta përgatisë njeriun për t'iu përshtatur kësaj bote, ndaj edhe vëmendja e shkollës duhet të priret drejt këtij funksioni jetësor. Përvoja e arsimit në Europë duhet të shërbejë si shembull, në mënyrë që arsimimi i brezit të ri të mbështetet mbi baza shkencore bashkëkohore.

BURIMET HISTORIKE NËN KËNDVËSHTRIMIN E RILINDËSVE DHE INTELEKTUALËVE SHQIPTARË

Në këtë artikull, duke u mbështetur kryesisht në një bazë të gjerë dokumentare, që ruhet pranë Arkivit Qendror të Shtetit, të Republikës së Shqipërisë (AQSH i RSH), në shtypin periodik të kohës dhe të literaturës së botuar, jemi përpjekur të japim disa aspekte të veçanta lidhur me shkrimin, ruajtjen, gjurmimin dhe vlerësimin e dokumenteve nga rilindësit dhe intelektualët shqiptarë gjatë viteve 1830-1912 e më gjerë. Vëmendja e tyre, lidhur me këtë pjesë të trashëgimisë së kulturës shqiptare, u përqendrua në dokumentet e krijuara në shekuj, ashtu dhe për dokumentet e krijuara nga ata vetë, gjatë veprimtarisë së tyre të gjithanshme politike, luftarake, kulturore dhe diplomatike, në shërbim të çështjes kombëtare. Ata i kanë parë ato si një dëshmi dhe mjet të fuqishëm për mbrojtjen e identitetit kombëtar, sepse përmbanin fakte të pakundërshtueshme ndaj qëllimeve dashakeqe të shteteve fqinje dhe shteteve të tjera të Europës ndaj Shqipërisë, kur territoret shqiptare ishin nën administratën e sundimit osman. Është kjo një nga arsytet që rilindësit dhe intelektualët shqiptarë u kujdesën në mënyrë të vazhdueshme për ruajtjen dhe gjurmimin e dokumenteve historike të shekujve të kaluar. Këto dokumente, gjithashtu, do t'u shërbenin atyre si burime të dorës së parë në studimet, të cilët ndërmoren për t'i bërë të njohur Europës lashtësinë dhe autoktoninë e shqiptarëve në krahinat e banuara prej tyre. Pikërisht, kjo ndjenjë atdhetare dhe politike bëri që ata të grumbullonin dhe të ruanin dokumentet.

POTENCIALET E ENERGJISË DIELORE NË VENDET E EUROPËS JUGLINDORE

Sot, teknologjia fotovoltaike është bërë një nga burimet më të rëndësishme në botë për të gjeneruar energji të pafundme. Qelizat fotovoltaike përbëjnë një teknologji të energjisë diellore që konverton rrezet e diellit në energji elektrike (efekt PV), duke përdorur përçueshmëri gjysmëpërçuese të njohur gjerësisht si qelizat PV. Zhvillimi i teknologjisë moderne fotovoltaike konsiderohet si një nga zgjidhjet për të përmbushur kërkesën në rritje për prodhimin e energjisë elektrike.

Ngruhja globale, ose ndryshimi i klimës, përcaktohet si ndryshimi drastik i temperaturës gjatë viteve të fundit, krahasimisht me trendin historik. Ky trend do të vazhdojë dhe madje do të përkeqësohet, nëse politikëbërësit nuk miratojnë masat e nevojshme për të mbrojtur planetin, të tilla si kufizimi i emetimit të gazit, minimizimi i burimeve të tij sa më shumë që të jetë e mundur dhe prezantimi i zgjidhjeve parandaluese. Një zgjidhje është zhvillimi më tej i teknologjisë së energjisë së rinovueshme, inkurajimi i investimeve në burimet e kësaj energjie dhe minimizimi i prodhimit të objekteve ndotëse.

Sipas një studimi të IRENA, të botuar në shkurt 2018, sistemet e energjisë së rinovueshme shumë shpejt po bëhen më të shtrenjta se teknologjia konvencionale e prodhimit të energjisë. Prandaj, çmimet e karburanteve fosile kanë rënë në dekadën e fundit dhe çmimet e teknologjisë së energjisë së rinovueshme po bien shpejt, falë zhvillimit të një tregu global më të fortë të kësaj energjie.

Ky punim përqendrohet në potencialin e energjisë diellore, të mirat dhe të metat e tij, duke veçuar Shqipërinë, ku potenciali i energjisë elektrike PV të saj është premtues dhe mund të shfrytëzohet për qëllime ngruhjeje, ndriçimi, ujitjeje, telekomunikacioni, mjekësi dhe arsimi.

KONTRIBUTI I TARIKATEVE ISLAME NË KOMITETIN "MBROJTJA KOMBËTARE E KOSOVËS"

Komiteti "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës" ishte një organizatë politike, qëllimi kryesor i së cilës ishte një Shqipëri e pavarur dhe e përfshiruar nga çdo lloj protektorati, shpëtimi i Kosovës dhe bashkimi i saj me Shqipërinë. Krahas themeluesve dhe drejtuesve të organizatës, u angazhuan edhe anëtarët e tarikateve islame, gjatë periudhës së ekzistencës së saj.

Për rolin e këtyre figurave historike në lëvizjen për çlirim e bashkim kombëtar, gjatë viteve 1918-1924 kanë shkruar shumë studiues seriozë, të cilët kanë trajtuar nga këndvështrime të ndryshme problemet e kohëzgjatjes së veprimtarisë së Komitetit MKK, evidentimin e tipareve të lëvizjes në segmente të caktuara të saj, përcaktimin e datave, vlerësimin e ngjarjeve e personaliteteve të veçanta.

SISTEMI EMËROR I TË FOLMES SË ISTOGUT ME RRETHINË

Në këtë punim është paraqitur sistemi emëror i arealit gjuhësor të Istogut me rrethinë. Është zgjedhur ky objekt trajtimi, duke u mbështetur në faktin se kjo e folme ende ruan trajta e forma fjalësh të moçme e të rralla të shqipes, siç janë: disa emra asnjans, apo formimi i rasës gjinore e dhanore në numrin shumës pa v epentetike. Këtu janë trajtuar të gjitha kategoritë gramatikore të emrit dhe disa çështje e aspekte, kundruar nga pikëpamja dialektore. Sistemi emëror në arealin gjuhësor të Istogut me rrethinë nuk ndryshon shumë nga ai i gjuhës letrare, por as nga të folmet e tjera të gegërishtes verilindore, mirëpo, krahasuar me shkrimet e vjetra të shqipes, dallimet janë të theksuara, p.sh.: numri më i vogël i rasave, ndryshimet në kategorinë e emrave asnjans, formimi i shumësit të emrave mashkullorë dhe disa lëkundje te mbaresat rasore. Kur kemi të bëjmë me sistemin emëror të arealit në shqyrtim, në mjaft raste vihet re paranyjëzimi i emrave, sidomos ata që tregojnë prejardhjen a origjinën e një njeriu, përkatësisht të një banori, p.sh.: i vréllsi (banori i Vrellës), i prigódsi (banori i Prigodës), i lübóvsi (banori i Lubovës) i rakóshsi (banori i fshatit Rakosh) etj. Ngjashëm, si në Istog, kemi hetuar se paranyjëzimi i emrave del edhe në të folmen e Plavës e të Gucisë e në ndonjë të folme tjetër.

KONTRIBUTI I EL-MESUDIT DHE EL-IDRISIT NË SHKENCËN E GJEOGRAFISË DHE HISTORISË

El-Mesudi dhe El-Idrisi, janë ndër shkencëtarët më të njohur muslimanë të periudhës së Mesjetës. Fama e këtyre shkencëtarëve nuk ishte vetëm në hapësirën e tokave muslimane, por arriti në katër anët e botës së njohur në atë kohë. El-Mesudi, gjatë jetës së tij, vizitoi shumë vende të ndryshme të botës, më qëllim hulumtimin e tyre. Po ashtu, gjatë vizitës së këtyre vendeve, ai shkroi shumë vepra të karakterit historiko-gjeografik, ku vepra më kryesore është “Muruj-el-Mezahabut ue el-Ma-Adin el-javahir”. Në këtë libër, ai jep shumë informacione teorike rreth gjeografisë botërore. Harta e punuar nga El-Mesudi, konsiderohet si harta më e saktë dhe më e plotësuar, në raport më të gjitha hartat e punuara më parë. Në këtë hartë, ai paraqet një tokë të madhe dhe identifikon një territor të panjohur, të shtrirë përtej oqeanit të errësirës dhe mjegullës (kjo tokë korrespondon me kontinentin e Amerikës, e zbuluar shumë vite më vonë).

El-Idrisi dha një kontribut të madh në zhvillimin e shkencës së gjeografisë dhe hartografisë. Disa studiues e konsiderojnë si gjeografin dhe hartografin më të madh në kohën e Mesjetës. Me qëllim mbledhjen e informacioneve sa më të sakta, ai udhëtoi në shumë vende të botës së njohur deri në atë kohë. Fama që fitoi gjatë udhëtimeve dhe studimeve të tij, bëri që mbreti i Sicilisë, Roxheri II, ta ftonte në pallatin e tij, për të punuar një Gjeografi Universale, të bazuar në të dhënat e vëzhguesve me përvojë. Procesi i grumbullimit dhe vlerësimit të materialit zgjati 15 vjet. Pas pesëmbëdhjetë vjetëve të shoshitjes së këtyre evidencave, filloi që të punohej harta. Pas përfundimit të hartës, ai realizoi një glob prej argjendi, me peshë prej 400 kg. Në këtë glob paraqiti shtatë kontinentet e botës, në mënyrë të detajuar. Këtij globi El-Idrisi i bashkëngjiti edhe një libër me titull “El-Kitab el-Ruxhari”, kurse Roxheri II e titulloi “Kitab nuzhat el-Mushtak fi Ikhtirak el-Afak”. Sa i përket formës së hartës në trajtë globi, ai shpjegon se globi simbolizon formën e tokës, sepse toka ka formë të rrumbullakët, e cila qëndron pezull në kozmos. Po në këtë libër, El-Idrisi tokën e ndau në shtatë zona klimatike.

HORIZONTE SHOQËRORE

Univers

TEK ARBËRESHËT E ITALISË

Shtator, 2018

Kumtesa e mbajtur nga Prof. Dr. Ramazan Bogdani në edicionin e dytë të veprimtarisë kulturore “Vëllazëria 2018”, me ftesë të komunitetit arbëresh në Itali, organizuar nga Qendra e Studimeve të Traditave Arbëreshe, “Skander”- Foggio dhe të Komunës Kasalvechio të Rajonit të Pulias. Kumtesa me titull “Hulumtime tek arbëreshët e Italisë dhe rituali i martesës (1990-2003)”.

Si rrjedhojë e një pune trembëdhjetëvjeçare, gjatë periudhës 1990-2003, janë kryer hulumtime në 27 katunde, nga pesë rajone arbëreshe të Italisë dhe është mbledhur një lëndë e pasur arbëreshe. Krahas filmimeve dhe fotografimeve në terren, kemi zhvilluar edhe bashkëbisedime të pafundme, duke vjelë dukuri tradicionale në përgjithësi dhe etno-koreografike në veçanti. Lënda e hulumtuar ndodhet e sistemuar shkencërisht në Arkivin e Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, në Tiranë. Gjithashtu, ajo ka gjetur jetë në botimet shkencore, duke përfshirë edhe 20 vëllimet e mia. Vetëm në Kalabri e Sicili u incizuan dhe u filmuan 119 këngë, 48 njësi vallëzimesh, biseda informative, 150 fjalë të urta, disa përralla, legjenda e ndonjë gjëegjëzë; u zhvilluan 4 filma fotografikë dhe disa kasete filmike.

Në vijim, artikulli ka si objekt vështrimi përgjithësues zhvillimet në katundin Kasalvechio të Pulias, gjatë veprimtarisë kulturore “Vëllazëria 2018”, ku dhjetëra ansamble kanë performuar këngë e valle arbëreshe, duke improvizuar ceremoninë dhe ritualet e dasmës arbëreshe. Ato shënuan kulme, sepse zbuluan vlerat më origjinale dhe estetike të tharmit të folklorit vendës. Artistët popullorë interpretuan me brishtësi, emocionalitet dhe kulturë artistike, duke i transmetuar këto rituale me një karakter të theksuar spektakolar. Sikundër u vu re edhe përpjekja për ta ruajtur të pastër kulturën autentike vendase, arbëreshe.

SHKODRA, NJË DËSHMI E KONVERGIMIT KULTUROR NË PANORAMËN E MES SHEKULLIT XIX

Koncepti i tokave të kufirit, e hulumtuar nga studiues të ndryshëm, ndihmon për të kuptuar pozitën e njerëzve, të grupimeve shoqërore tranzite e në lëvizje, dhe se si individë nga vende të ndryshme vepronin me njëri-tjetrin. Një rast i tillë, është qyteti i Shkodrës, si një qendër e rëndësishme ekonomike e kulturore në shekullin XIX.

Një qytet me tipare të tokave në kufi, Shkodra ofronte një klimë kulturore e institucionale, gjë e cila favorizonte komunikimin midis komuniteteve të ndryshme. Ndonëse interesat politike shpesh diktonin e ndryshonin gjeografinë sociale, ngjashmëria semantike midis vendeve, të atij që individë lë pas dhe atij ku do të gjente strehim, ishte e domosdoshme. Një rol të rëndësishëm luanin komunitetet e krijuara, të cilat përbënin një rrjet bashkëpunimi midis grupeve, që mbeteshin si referenca dhe mbështetja e rrjeteve komunitare të krijuara në qytete si Shkodra.

Duke u bazuar në burimet arkivore, artikulli synon të tregojë prezencën dhe artikulimin e grupeve shoqërore në “të jetuarit në kufi”, veçanërisht atë të qyteteve-porteve osmane. Njëkohësisht, kjo analizë e shkurtër, që meriton akoma më shumë vëmendje, dëshmon edhe rëndësinë e shtjellimit të jetës dhe lëvizjes së individëve, nëpërmjet dokumentit arkivor, kjo pasi te këto burime kuptohen politikat e kohës në krijimin e gjeografive identitare në mesin e shekullit XIX, në qytete si Shkodra.

Dr. Armanda Hysa

METODOLOGJIA E MBLEDHJES SË MATERIALEVE MBI JETËN TRADICIONALE NË ETNOGRAFINË SHQIPTARE GJATË DIKTATURËS

Në këtë artikull do të trajtoj metodologjinë e përdorur për mbledhjen dhe arkivimin e të dhënave mbi jetën tradicionale në qytete dhe mbi zejet qytetare. Qëllimi i këtij artikulli është të analizojë këtë metodologji për të kuptuar se sa dhe si mund t'i përdorim këto materiale sot. Për të arritur qëllimin kryesor, fillimisht do të paraqesim shkurt disa nga tiparet e metodologjisë së përdorur nga etnografët, pasi ajo është përdorur deri në një farë mase edhe nga etnografët dhe bashkëpunëtorët e sektorit e më vonë, të Departamentit të Etnografisë, që kanë mbledhur të dhëna për jetën tradicionale në qytetet shqiptare. Bazuar në disa nga materialet e arkivuara, do të paraqesim shkurt se çfarë mblidhnin dhe si e bënin këtë. Në këtë pikë një vëmendje e veçantë do t'u kushtohet udhëzimeve të pyetësorit mbi zejet. Në fund, do të analizojmë mënyrën se si këto të dhëna regjistroheshin në arkiv.

SFONDI ESTETIK NË POEMËN “DASHURIA” (EROS) TË NAIM FRASHËRIT

Letërsia orientale, përmes poezisë mistike, kaloi në letërsinë dhe në kulturën shqiptare. Naim Frashëri është personifikim i kësaj ure të kalimit të vlerave mistike orientale në hapësirat shqiptare. Temat mbi të cilat do të qëndrojmë dhe të cilat janë qendrore në poezinë e Naimit, janë: Zoti, e bukura, dashuria dhe ekstaza si rrugë për arritjen te Zoti.

Këto vlera te Naimi janë pjesë e pandarë e formimit intelektual të tij. Idetë e tij mbi të bukurën, janë të shpërndara në vepra të ndryshme, por në poemën “Eros” (dashuria), ai e paraqet në mënyrë tërësore botëkuptimin e vet mbi këto çështje. Te Naimi ndikim të madh kishin poetët persianë Xhelaluddin Rumi, Farid ud-din Attari, Ibn Arabiu etj., pasi ai i lexonte veprat e tyre në gjuhën origjinale. Ndikimi i tyre vërehet në konceptin e njëshmërisë së qenies (vahdeti vuxhud), e cila ndihet në tërë veprimtarinë e Naimit dhe shpeshherë quhet panteizëm, sipas konceptit perëndimor. Por panteizmi i tij nuk është i llojit perëndimor të Spinozës, ai është panteizëm i stilit oriental, konkretisht, koncepti i filozofisë islame. E them këtë, duke u bazuar në faktin se Naimi e unifikon Zotin me të bukurën dhe dashurinë, e njëjtë kjo me unifikimin që bëu Rumi në veprat e tij, në dallim nga Spinoza, i cili e kërkon unifikimin e Zotit në bazë të intelektit. Spinoza e kërkon Zotin tek etika, kurse Rumi dhe Naimi tek estetika.

ART, KULTURË DHE TRADITË

Univers

NJË DIJETAR E PATRIOT QË MERITON NJË VEND TË VEÇANTË NË PANTEONIN KOMBËTAR TË DIJES DHE TË ATDHEDASHURISË

Frymëzimi për shkrimin e këtij artikulli më erdhi nga dy personalitete të shquara: studiueses së apasionuar shqiptare, Manushaqe Halili, e cila gjithë jetën e saj ia dedikoi zbulimit të kontributeve të rëndësishme të Hoxha Tahsinit, në veçanti për gjetjen dhe nxjerrjen në pah të punës së madhe të këtij dijetari dhe patrioti të famshëm shqiptar. Personaliteti i dytë është një kolegj turk që e vlerësoj shumë, Prof. Ekmeleddin Ihsanoglu, i cili, përpos veprimtarisë së tij politike, ka botuar një sërë studimesh shkencore e monografi, (në turqisht ose anglisht, të përkthyer në shumë gjuhë të botës), mbi qytetërimin osman, shtetin dhe shoqërinë, përfshirë shkencën, edukimin, literaturën shkencore etj.

Prof. Ihsanoglu e konsideronte Hoxha Tahsin Efendiun si “një nga pionierët e shkencave moderne të shekullit të 19-të në Perandorinë Osmane”. Ai gjithashtu i kushton vëmendje të veçantë rolit të Hoxha Tahsinit si drejtor i Universitetit “Darülfünun” (Universitet Osman), në librin e tij “Shtëpia e shkencave: Darülfünun” (Botuar në shtypin e Univerisitetit të Oxfordit). Ndërkohë, duke u bazuar në dokumentet, në librin e tij me dy vëllime, të botuar në turqisht në vitin 2017, të titulluar “Trashëgimia Shkencore Osmane” (Osmanlı Bilim Mirası), e ka përzgjedhur Hoxha Tahsinin “si një nga 290 dijetarët e shquar midis mijërave prej tyre, gjatë periudhës së gjatë osmane 6-shekullore”. Këta dy persona më kanë ndihmuar të kuptoj më mirë kontributin dhe madhështinë e Hoxha Tahsinit, i cili, duke qenë gjithmonë nën një shtrengim dhe presion të atyre që e rrethonin, është përpjekur të tejkalojë kufijtë e kohës së tij, gjithnjë i ushqyer nga përkushtimi i një eruditi ndaj universit, krijimit të tij, dijes dhe shkencës. Qëllimi im në këtë punim është të përçoj te lexuesi konsideratat e mia të rifreskuara, vlerësimet e mia konkrete dhe ndjenjat e vërteta për Hoxha Tahsinin, për madhështinë dhe peshën e këtij personaliteti shumë të veçantë shqiptar, mbi punën e tij frymëzuese, jetës së tij shumëngjyrëshe dhe patriotizmi të ndezur.

ANALIZË SOCIOLOGJIKE E FESË, EDUKIMIT DHE FAMILJES: SHEMBULLI I ROLIT TË GRUAS NË ISLAM

Në literaturën sociologjike dhe të shkencave të ndryshme sociale, familja, edukimi dhe feja janë ndër institucionet kryesore sociale më të rëndësishme të një shoqërie. Në funksionim të rregullit dhe solidaritetit social, të tre këto institucione ndërthuren në funksionimin e shoqërisë. Edukimi është një nga institucionet më të rëndësishme shoqërore në çdo shoqëri, e cila promovon dhe mundëson transmetimin e njohurive dhe aftësive nëpër gjenerata. Edukimi në vetvete ndahet sipas formave të tij, formal dhe joformal. Edukimi formal (i cili zhvillohet në institucione arsimore) u mundëson fëmijëve të përvetësojnë aftësi profesionale, por edhe rregullat shoqërore që kontribuojnë në funksionimin e shoqërisë. Sipas Durkheim, edukimi luan një rol të rëndësishëm në socializimin e fëmijëve, sepse fëmijët fitojnë aftësi për të kuptuar vlerat e përbashkëta në shoqëri, duke bashkuar një mori individësh të veçantë. Edukimi joformal, që njihet dhe si procesi i socializimit, fillon në familje (si institucion social) dhe e ka vazhdimësinë deri në fund të jetës së individit. Gjatë këtij procesi, aktori social mëson rregullat kryesore të familjes, rreth mënyrës së organizimit të jetës si dhe marrjen si shembull të modeleve kryesore të pjesëtarëve të saj, veçanërisht të prindërve. Gruaja, si nënë, luan një rol shumë të rëndësishëm gjatë procesit të socializimit, por edhe gjatë gjithë jetës së individit. Ashtu si edukimi dhe familja, edhe feja është një institucion social shumë i rëndësishëm për t'u analizuar nga qasjet sociologjike. Ky institucion paraqet besimet fetare me dimensione sa individuale, aq edhe shoqërore në jetën e përditshme të individëve. Parsons argumenton se feja është shumë e rëndësishme jo vetëm për solidaritetin personal, por edhe për solidaritetin dhe stabilitetin social. Sipas tij, një ndër qëllimet kryesore të fesë është dashuria për njerëzit, jetën, të ardhmen etj. Rolin kryesor për këtë transmetim e realizojnë prindërit, nëpërmjet modeleve që paraqesin gjatë periudhës së socializimit.

Në këtë studim, do të realizohet analizimi deskriptiv sociologjik, sipas qasjeve moderne, rreth institucioneve kryesore sociale të edukimit, si familja dhe feja, duke marrë si shembull rolin e gruas në fenë islame.

PRANIA E MITIT NË VEPRËN “KËSHTJELLA” TË KADARESË

Rëndësia e kësaj analize konsiston në shfaqjen dhe trajtimin e elementeve mitike në veprën “Kështjella” të Ismail Kadaresë, për të hedhur dritë në anën strukturore të veprës, me qëllim shfaqjen e rëndësisë së saj në rrafshin dhe në meritat letrare. Vëzhgimi kryhet nisur prej leximeve në rrafshin antropologjik dhe prej studimeve letrare që vërtiten në të njëjtin qerthull. Subjekti është i ndërtuar në një kohë të largët, ngjarjet janë vendosur në kohën e Perandorisë Osmane dhe të Skënderbeut, në kohën e kështjellave dhe të perandorive, në kohën kur pritet një luftë me Kostandinopolin.

E gjitha kjo, në kohën kur Kadareja po shkruante romanin, ishte një kohë e largët, e cila në sytë e lexuesit për nga rëndësia vjen vetëm në formën e mitit. Duke zgjedhur një perandori si subjektin kryesor, në rastin e “Kështjellës” nuk kemi personazhe të hiperbolizuara prej autorit, të cilët synojnë të zënë vendin e parë për nga rëndësia e masës përshkrimore nga ana e tij. Madje kemi një rend të caktuar personazhesh, të radhitur sipas funksionit të tyre, sikurse hierarkia e një perandorie dhe Skënderbeu, nga ana tjetër, si figura qendrore e kështjellës, në këtë rast e shqiptarëve. Hiperbolizimi i këtyre personazheve vjen vetëm si rast i figurave të përdorura nga autori në përshkrimin e tyre, duke u rrekur të bëjë portretin dhe dialogët që i vendos në gojën e tyre.

Një tjetër element mitik ndihet në fjalëformimin, në zgjedhjen e emrave të personazheve, jo vetëm në zgjedhjen e emrave të vjetër, por dhe aq të goditur për nga rëndësia dhe mesazhi që përcjellin. Romani “Kështjella” na vjen me paragrafë në fillim të çdo kapitulli, me një parashtrim të ngjarjeve, me një subjekt prej të cilit priten ngjarje të mëdha, sepse është fokusuar vetëm në pushtimin e kështjellës me personazhe të zgjedhura. E gjitha kjo, vjen me një gjuhë moderne, një mendim më të emancipuar, lirshmëri mendimi dhe që të detyron të bësh reflektime kundrejt ngjarjeve historike dhe jo atyre bashkëkohore.

OPINIONE

Univers

Dr. Husein Rizai

HUTBEJA SI BARTËSE E MESAZHIT HYJNOR NË BOTËN MODERNE

Komunikimi është bërthama elementare e shpalljes hyjnore, po ashtu, edhe e dërgesës peygamberike. Teksti i shpalljes dhe porositë peygamberike kanë për qëllim t'i komunikohen në trajta të ndryshme gjinisë njerëzore. Pikërisht për këtë, metodologjia e komunikimit të diskursit hyjnor dhe atij peygamberik ka ngjallur interesin e veçantë të filozofisë së gjuhës kuranore dhe të haditheve të Pejgamberit (a.s.). Gjithashtu, një nga problemet dhe defektet kryesore të gjuhës religjioze në botën bashkëkohore është hendikapi (mangësia) i komunikimit joadekuat dhe trajtës jofetare të përdorimit të gjuhës së Shpalljes dhe bisedës profetike.

E DREJTA ISLAME

Përtej të qenit një hierarki aksiologjike e ndryshme nga qytetërimet e tjera, përfshi atë të krishterë, Islami duhet këqyruar si rrjedhoja e natyrshme e evolucionit mendor e shpirtëror të disa popujve, të cilët, ndryshe nga ata që banojnë në Europë, kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë një mënyrë jetese të vetën, në pajtim me mjedisin, ndonjëherë jo fort pjellor, dhe realitetet historike u kanë diktuar ngjizjen e një bote shpirtërore të mirëdallueshme.

Mendimi juridik, duke qenë vetëm një nga përbërësit e çdo qytetërimi, mund të zbërthehet në kontekstin e dukurisë që e jetëson. Aq më tepër kur bëhet fjalë për Islam, për të cilin Raymond Charles është shprehur: “Islami (nga: selam – “nënshtrim ndaj Allahut”) është para së gjithash fe, pastaj shtet e, më në fund, kulturë”. Duke mos qenë konservator e ca më pak fanatik, Islami, edhe në sistemin juridik të së drejtës, ka ndjekur hap pas hapi zhvillimet e sotme, duke mos mohuar apo shpërfillur aspak sistemin juridik europian.

Veprimtaria e kësaj feje zhvillohet përmes institucionesh, të cilat njëherazi janë edhe norma juridike dhe mbështeten, në radhë të parë, në pesë “shtyllat e besimit”: shalati - kulti i lutjes kanonike; zekati - mëshira e ligjëruar; shauni - mbajtja e Ramazanit; haxhi- pelegrinazhi; shehadeti - profesioni i besimit, që konsiston në përsëritjen e formulës: “Nuk ka Zot tjetër veç Allahut dhe Muhamedi është i dërguari i Tij”. Feja islame ka dy aspekte, teologjinë që përcakton dogmat, duke saktësuar besimin e çdo muslimani, dhe sheriatin (rrugën që duhet ndjekur) – një tërësi rregullash sjelljeje, të cilat çdo besimtar duhet t’i mbajë mirë parasysh. Aktualisht, në parim, shtetet islamike kanë adoptuar kode sipas modelit europian, që përfaqësojnë shartesa të parimeve të së drejtës muslimane me shkencën juridike europiane. Ndryshe nga e drejta europiane, juristi musliman ka vizionin e vet që përfshin zgjidhje konkrete për secilin rast më vete, duke mënjanuar përgjithësimet ose përkufizimet.

KOMUNIKIMI MUZEOR SI DËSHMI E LASHTËSISË DHE E IDENTITETIT KOMBËTAR

Libri “Komunikimi Muzeor” i autorit Shefki Stublla, i përbërë prej dy vëllimesh, është një studim teorik e praktik, hulumtim i mirëfilltë tërësor. Autori, në cilësinë e profesorit, synon t’u përcjellë studentëve, muzeologëve të ardhshëm në Kosovë dhe në Shqipëri njohuritë teorike e praktike dhe përvojën vetjake shumëvjeçare, por edhe atë botërore në komunikimin muzeor, por jo vetëm.

Tema kryesore e këtij libri është komunikimi i organizuar muzeor ndër ne, por edhe format e tjera të komunikimit në familje e me gjerë. Me të drejtë, autori përpiket të paraqesë sa më saktë historinë e komunikimit muzeor, kushtet ekonomike-historike të njerëzve të asaj treve, të cilët me shumë mund dhe në rrethana tepër të vështira nga pushtimet shumëshekullore, arritën të mbronin të kaluarën, duke ua lënë si dëshmi dhe pasuri pasardhësve të tyre.

Autori e sheh dhe vlerëson muzeun si “një urë komunikimi me tri harqe”, që lidh të djeshmen (të kaluarën), të sotmen (të tashmen) dhe të nesërmen, duke hapur rrugët e së ardhmes.

Punimi përmban një vështrim panoramik të librit me dy vëllime, për t’i ardhur në ndihmë muzeologëve apo kërkuesve shkencorë të cilët merren me këto studime. Rëndësi të veçantë i është dhënë rolit që ka muzeu dhe komunikimit me të për të mbrojtur identitetin kombëtar.

Muzeu, në të shumtën e rasteve, konsiderohet si një barnatore shpirtërore, ku çelen sytë, ku freskohet mendja, ku zgjerohet dija, ku gjenden këshillat mendore të përvojës për ecje përpara.

Ndaj është e rëndësishme të njihemi me të, të japim ndihmesën tonë dhe t’i mësojmë brezat në vazhdim për rëndësinë e tij, si një nga shtyllat kryesore të ruajtjes së identitetit tonë kombëtar.

HISTORIA E INSTITUCIONEVE ARSIMORE ISLAME TË ZONËS SË SHKODRËS: MEJTEPET

Depërtimi në shkallë të gjerë i fesë islame në radhët e popullsisë shqiptare gjeti shprehje, pikë së pari, në qytete. Me vendosjen e osmanëve në qytetet shqiptare, ato filluan të funksionojnë si qendra administrative, ekonomike e kulturore të sistemit të ri politik. Në përshtatje me rolin e tyre ekonomik e shoqëror, në qytete u përqendrua jo vetëm shumica e personelit administrativ e ushtarak, por edhe misionarët, ulematë, dijetarët dhe predikuesit islamë, në fillim të ardhur nga jashtë dhe më vonë vendas, së bashku me institucionet e kultit, që u ndërtuan dhe u shumuan.

Me rritjen e popullsisë muslimane, pothuajse çdo lagje kishte xhaminë e vet. U bë zakoni dhe traditë, që në qendër të çdo lagjeje të qytetit dhe të fshatit të ndërtoheshin xhami, teqe, mejtepe, të cilat u shoqëruan edhe me ndërtimin e komplekseve arsimore e kulturore, në shërbim të tyre. Po kështu, u ndërtuan çezma, puse, hamame nga bamirës me zemër të madhe e bujare. Me interes të madh ishte ndërtimi i institucioneve arsimore e kulturore fetare, si mejtepe, ruzhdije e medrese. Rrjeti i shkollave shënon një rritje që ecte paralelisht me zgjimin e ndërgjegjes kombëtare. Ka dokumente që vërtetojnë se në vitin 1894-95 ekzistonin 101 shkolla të tilla në qytet e në fshat, 75 të sistemit të vjetër e 26 shkolla të sistemit të ri. Në mejtepe fëmijët merrnin dije teorike dhe praktike elementare mbi fenë islame, se si duhet të sillej fëmija në familje e në shoqëri, por dhe një nivel arsimor që nuk duhet anashkaluar.

Mejtepet në Pazar të Vjetër qëndruan të hapura deri në vitin 1910, kohë në të cilën roli i këtij pazari erdhi duke rënë, pasi tregtia u zgjerua në qytet dhe tashmë fëmijët shkodranë vijuan të merrnin mësimet në mejtepet e lagjeve të tyre. Në vitet e fundit u futën metoda më të avancuara mësimdhënieje, që u përvetësuan nga hoxhallarët-mësues. Kjo krijoi një vijimësi të suksesshme, pasi djemtë që kryenin mejtepin, kishin të drejtë të vijonin shkollimin e mëtejshëm, në medrese apo në ruzhdijet e Shkodrës dhe më tej.

KRIZA FINANCIARE GLOBALE DHE NDIKIMI I SAJ NË BANKAT KONVENCIONALE DHE ATO ISLAME

Shfaqjet e para të krizës financiare e kanë burimin nga vendi më i zhvilluar në botë, nga SHBA-të, dhe gjendja vazhdon të jetë ende alarmante. Kjo krizë erdhi për shumë arsye, por, duke e përfshirë në një fjalë të vetme, mund të themi se: flukset dalëse të parasë ishin më të mëdha se flukset hyrëse të saj dhe kjo uli aftësinë blerëse në treg, e cila po shkon drejt një recesioni të plotë në të gjithë botën. Mirëpo, ndikimet e kësaj krize nuk ishin të njëjta në të gjitha shtetet dhe të gjitha sistemet financiare të tyre. Në botë ekziston një sistem që pothuajse nuk është luhatur fare në gjithë këtë situatë tollovie që është krijuar dhe ai është sistemi bankar islam. Atëherë, gjithsesi, duhet të merret parasysh dhe të shqyrtohet edhe mundësia e aplikimit të metodave të këtij sistemi. Për të parë më mirë këtë ndikim të krizës financiare, do t'i qasemi së pari, dallimeve ndërmjet këtyre dy sistemeve në fjalë. Sistemi bankar islam është një sistem që ndan humbjen dhe fitimin PLS (Profit and Loss Sharing), jo i bazuar thjesht mbi kamatën, sikurse në kapitalizëm. Përfitimi është i bazuar në produktivitetin dhe performimin e projektit. Ky sistem kërkon që të gjithë faktorët ekonomikë të aktivizohen në mënyrë produktive dhe jo disa të bëhen klasë parazite që jetojnë nga të ardhurat e kamatës dhe, në të njëjtën kohë, të bëhen barrë e shoqërisë dhe pengesë e progresit shoqëror në përgjithësi, e cila shpie drejt një humbjeje të potencialit prodhues. Në sistemin konvencional investitori ballafaqohet me një pasiguri në të cilën rezultatet e projektit apo biznesit të tij nuk mund të parashihen me një siguri të madhe, ndërsa ai është i detyruar të përcaktojë veten e tij, të paguajë një shumë të kamatës, e cila është e paracaktuar. Ndonjëherë, ndodh që nga pasiguria e rezultatit përfundimtar, investuesi të lërë projektin për të cilin kamata duhet të paguhet patjetër. Kështu, nëse banka kamatore ka për qëllim grumbullimin e mjeteve financiare dhe ofrimin e tyre për ata që kanë nevojë për mjete financiare, me qëllim që në këtë mënyrë banka të përfitojë; banka islame ka për qëllim ngritjen e shoqërisë dhe mëkëmbjen e ekonomisë islame, përmes orientimit të drejtë të pasurisë, normalisht duke pasur parasysh prioritetet dhe duke marrë pjesë në fitim.

KONVENTAT NDËRKOMBËTARE MBI PËRFAQËSIMIN DIPLOMATIK DHE RASTET PRAKTIKE TË FUNKSIONIMIT TË TYRE

Vendosja ligjore e lidhjeve diplomatike në tërësinë e aspekteve të tyre, formon një nga shprehjet e hershme të ligjit ndërkombëtar ekstraterritorial që vazhdon të evoluojë deri në ditët e sotme, rëndësia e të cilit shprehet dukshëm në marrëdhëniet e vendosura ndërmjet shteteve. Historia botërore ndër vite, ka dëshmuar se nuk ka pasur realisht një grup shtetesh, të cilat bashkekzistojnë ndërmjet tyre në mënyrë të pavarur, që të kenë përcaktuar rregulla të veçanta mbi mënyrën se si ambasadorët dhe përfaqësuesit e shteteve të tjera duhet të trajtohen.

Diplomacia, si pjesë e këtyre rregullave midis grupeve të ndryshme të shteteve, duke përfshirë edhe negociatat midis agjentëve të njohur, është një institucion juridik dhe një parashikim ligjor ndërkombëtar, shprehje e një treguesi të praktikës shekullore të një shteti.

E drejta diplomatike, si pjesë e së drejtës ndërkombëtare dhe asaj europiane, luan një rol kryesor në marrëdhëniet ndërmjet shteteve, mes Lindjes dhe Perëndimit, e cila ndikon dukshëm në përmirësimin dhe zhvillimin e tyre. Ajo ka lindur së bashku me to dhe mund të analizohet e pandarë, pasi një shtet i mirorganizuar nuk mund të veprojë në marrëdhëniet ndërkombëtare, pa zotëruar mjete të përshtatshme të juridiksionit diplomatik. Privilegjet e veçanta diplomatike dhe imunitetet që lidhen me personalitetin diplomatik e konsullor të llojeve të ndryshme, u formuan pjesërisht si rrjedhojë e imuniteteve sovrane, pavarësisë e barazisë së shteteve dhe pjesërisht si një element i domosdoshëm i një sistemi ndërkombëtar, funksionimi i të cilit varej në mënyrë të drejtpërdrejtë nga përcaktimi i tyre.

Të gjitha këto marrëdhënie të veçanta ndërmjet shteteve nuk do të zhvilloheshin, nëse nuk do të konkretizoheshin nëpërmjet dispozitave dhe akteve ndërkombëtare të miratuara për këtë qëllim, të cilat do të trajtohen më hollësisht në këtë punim, duke e vendosur theksin edhe te trajtimi i tyre praktik.

DOKUMENTE

Univers

MARRËDHËNIET MIDIS KOSOVËS DHE SHQIPËRISË NË VITIN 1974

- Sipas një raport-programi sekret të Mr. Ukshin Hotit –

Raport-programi me titull: “Marrëdhëniet midis RSF të Jugosllavisë dhe të RP të Shqipërisë-Pozita e KSA të Kosovës dhe detyrat e saj”, është përpiluar në vitet ‘70 të shekullit të kaluar nga Mr. Ukshin Hoti, politologu e veprimtari i njohur nga Kosova, i cili tani figuron në listën e personave të zhdukur nga lufta e fundit në Kosovë. Si njëri nga udhëheqësit e Sekretariatit Krahinor për Marrëdhënie me Botën e Jashtme, me qendër në Prishtinë, në vitet 70, në mesin e shumë punëve të vyera që kishte bërë Mr. Ukshin Hoti dhe ekipi i tij, ishte edhe ky Raport-program i cili mban datën 20 nëntor 1974. Ky dokument, asokohe, i qe dërguar Kryesisë së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Dokumenti i përpiluar në disa faqe dhe që mban shënimin “Tepër sekret”, është objekt trajtimi në këtë punim.

Përkitazi me këtë, në këtë punim, prezantohet vizioni i Mr. Ukshin Hotit dhe ekipit tij, mbi Marrëdhëniet midis RSF të Jugosllavisë dhe të RP të Shqipërisë” gjatë viteve 70, me theks të veçantë pozitën e Kosovës në këto marrëdhënie. Kosova, siç dihet, ishte pjesë përbërëse e ish-Jugosllavisë. Mr. Ukshin Hoti dhe ekipi i tij në këtë dokument, janë të mendimit së marrëdhëniet mes dy vendeve duhet të përqendrohen në fushën e ekonomisë, kulturës dhe arsimit. Por, para se këto marrëdhënie të zyrtarizohen, sipas përpiluesve të këtij dokumenti, duhet të ketë diskutime në vendin tonë, pastaj mbarëvajtja të përcillet nga nivelet zyrtare.

BOTIME NË FOKUS

Univers

Prof. Dr. Mustafa Ibrahim

VEPRA “AREALI GJUHËSOR I ISTOGUT ME RRETHINË” E AUTORIT DR. SEJDI GASHI, VLERË E RE PËR GJUHËSINË SHQIPTARE

(Studim monografik, botoi: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2018, f. 332.)

Vepra e Dr. Sejdi Gashit, Areali gjuhësor i Istogut me rrethinë, zgjeron edhe më tej studimet e dialektologjisë shqiptare. Sikurse mund të shihet edhe prej kësaj strukture, studimi i Dr. Sejdi Gashit hapet si kërkim antroponomografik, një traditë kjo e pranishme pothuajse gjatë gjithë shekullit XX, vazhdon me identifikimin e dukurive fonetike, përmes komunikimit të drejtpërdrejtë në terren, duke përdorur edhe përshkrimin sa më të saktë, përmes shenjave dialektike. Pastaj sjell një sintezë të analizës morfologjike e sintaksore dhe përmbillet me një numër tekstesh popullore e një fjalorth dialektor, me të cilin bën të mundur jo vetëm leximin e teksteve me interes për intonacionin dhe kuptimet morfosintaksore, por edhe njohjen e gjithë korpusit leksikor të kësaj treve. Autori përdor disa metoda me mjaft sukses, siç janë: metoda e analizës teorike, metoda e analizës së dokumentacionit, metoda përshkuese, metoda krahasuese dhe metoda statistikore. Nga rezultatet, dëshmon se i njeh metodat, duke filluar nga përzgjedhja e pyetësorëve, analiza teorike e tyre, krahasimi i rezultateve, përshkrimi i tyre dhe dhënia e statistikave nëpërmjet dhjetëra tabelave dhe grafikëve të ndryshëm.

Autori ka shfrytëzuar literaturë të nevojshme dhe me titujt e shfrytëzuar ka dëshmuar se ka njohuri për problemin që ka ngritur. Citimet i ka përdorur sipas stilit APA. Studiuesi Gashi në këtë punim ka dëshmuar se është mjaft i përgatitur në aspektin teorik për termat kyçe të punës së tij hulumtuese, siç janë: vjelja e materialit në terren, analiza teorike gjuhësore e të folmes së Istogut etj.

MONOGRAFIA “BANESAT SHQIPTARE ME QOSHK” E PROF. DR. EMIN RIZA. DËSHMI E ZHVILLIMIT TË ARKITEKTURËS SHQIPTARE

Prof. Dr. Emin Riza është një ndër emrat më të shquar të restauruesve shqiptarë dhe njohës i mirë i monumenteve kulturore në Shqipëri. Me një eksperiencë të gjatë pune në Institutin e Historisë dhe të Gjuhësisë, apo si specialist restaurues në Institutin e Monumenteve të Kulturës, ai fitoi një eksperiencë të madhe në fushën e ndërtimeve të vjetra, gjë që i shërbeu edhe për realizimin e 16 monografive. Duke qenë për disa vite kryeredaktor i revistës “Studia Albanica” dhe “Monumentet”, ai botoi një sërë artikujsh edhe në këto dy revista.

Monografia me titull “Banesa shqiptare me qoshk”, botuar në fund të vitit 2018 nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, përbën një studim që përmbush nevojën e trajtimit të veçantë të kësaj lloji banese, për të shtjelluar më gjerësisht vlerat kompozicionale të elementeve arkitekturore, strukturave teknike, materialeve ndërtimore etj. Në pesë kapituj shtjellohet evoluimi i banesave popullore shqiptare, deri në tipin më të ri, atyre me qoshk.

Siç nënvizon edhe autori në librin e tij, deri më sot, si datën më të hershme të ndërtimit të një banese me qoshk njohim vitin 1764, konkretisht banesa e miqve të familjes së Toptanëve, në Kalanë e Krujës. Më pas, ky lloj ndërtimi u përhap gjerësisht, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë. Megjithatë, trysnia e kohës, katastrofat natyrore dhe njerëzore, si tërmetet dhe zjarret, patën pasoja dëmtuese, deri shkatërruese të banesave. Kjo solli rindërtime të pjesshme dhe rrallëherë tërësore të banesave të vjetra, si edhe shtesa të improvizuara. Për rastin në fjalë, shumë banesa me qoshk u modifikuan, duke e mbyllur qoshkun, për të plotësuar nevojat familjare në rritje numerike dhe të kërkesave jetësore. Kjo është një ndër arsytet që në ditët e sotme është mjaft e vështirë të evidentojmë banesa monumentale tipike shqiptare ekzistuese.